

VENDIM
Nr. 526, datë 29.7.2022

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR DIALOG
DHE BASHKËQEVERISJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikave 2 e 7, të nenit 14, të ligjit nr. 107, datë 4.11.2021, “Për bashkëqeverisjen”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si person juridik publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

3. Agjencia ka si mision të sigurojë që të realizohet bashkëqeverisja me qytetarët, nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimit të pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjes së përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore, si dhe të realizojë, të nxisë dhe të mbështesë nismat për një shoqëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve dhe shoqërisë civile.

4. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Agjencia”**, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, e parashikuar në ligjin nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

b) **“COD”** (shkurtesa e emrit në anglisht “*Center for Openness and Dialogue*”), Drejtoria e Qendrës për Hapje dhe Dialog, e cila është pjesë e strukturës dhe organikës së Agjencisë, sipas përcaktimit të pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi;

c) **“Rrjet i koordinatorëve”**, tërësia e koordinatorëve të Agjencisë, që veprojnë pranë institucioneve të tjera, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për bashkëqeverisjen;

ç) **“Platformë”**, platforma “Me ty, për Shqipërinë që duam”, sipas kuptimit dhe përmbajtjes së përcaktuar në dispozitat e ligjit për bashkëqeverisjen;

d) **“Gjobë”**, sanksioni administrativ që vendoset nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për kundërvajtjet administrative, sipas përcaktimeve në ligjin për bashkëqeverisjen dhe këtë vendim.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Në përputhje me ligjin për bashkëqeverisjen, Agjencia ka përgjegjësi funksionale të organizojë punën, për:

a) krijimin e kushteve dhe nxitjen e ndërveprimit ndërmjet administratës shtetërore dhe individëve, personave fizikë dhe juridikë dhe grupeve të interesit, pavarësisht formës së tyre të organizimit, me qëllim rritjen e rolit të tyre në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e nismave, të projekteve ose programeve të përbashkëta, që kanë si qëllim përfshirjen e qytetarëve në bashkëqeverisje përmes platformës “Me ty, për Shqipërinë që duam”;

b) realizimin dhe mbështetjen e projekteve e të programeve për institucione më pranë qytetarëve, shoqërisë civile, rinisë dhe aktorëve të tjerë, në fusha të ndryshme, si: inovacioni, krijimtaria, transparenca, arsimi, rinia, shkenca, arti, kultura, grupet vulnerabël, nëpërmjet COD dhe jo vetëm.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

1. Agjencia e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në formën e drejtorisë së përgjithshme, në nivel qendror. Pjesë e strukturës dhe organikës së Agjencisë janë “Rrjeti i koordinatorëve” dhe “COD”.

2. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

4. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga Kryeministri, pas propozimit të drejtorit të përgjithshëm.

5. Agjencia drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj, përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet përpara Kryeministrit. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin për bashkëqeverisjen dhe legjislacionin tjetër në fuqi, kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Përcakton objektivat vjetorë të Agjencisë, në përputhje me objektivat strategjikë të miratuar nga Kryeministri dhe harton planin vjetor të punës së institucionit;

b) Drejton procesin e planifikimit buxhetor dhe të raportit vjetor të punës;

c) Raporton në mënyrë periodike dhe sa herë që kërkohet te Kryeministri për veprimtarinë e institucionit;

ç) Drejton punën për përgatitjen e rregullores që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë dhe/apo ndryshimet e saj dhe e dërgon atë për miratim te Kryeministri;

d) Përgatit kërkesat e veçanta të vendit të punës për rekrutimin e nëpunësve/punonjësve të Agjencisë dhe emëron nëpunësit dhe punonjësit, në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë;

dh) Nxjerr akte administrative për realizimin e funksioneve të Agjencisë, si dhe akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme, të detyrueshme për nëpunësit e Agjencisë;

e) Nënshkruan marrëveshje me njësitë e vetëqeverisjes vendore apo institucione/organe të tjera publike, vendëse ose të huaja, në përputhje me parashikimet ligjore;

ë) Autorizon me shkrim delegimin e pjesshëm apo të plotë të kompetencave, në rast të mungesës së tij;

f) Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi dhe Kryeministri.

6. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë emërohet nga Kryeministri dhe duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në ligjin për bashkëqeverisjen. Ai lirohet apo shkarkohet nga detyra nga Kryeministri, kur:

a) plotësohen kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm të interesit;

d) ristrukturohet institucioni;

dh) ka një performancë të dobët;

e) jep dorëheqjen nga detyra;

ë) kryen shkelje të rënda të detyrës.

7. Agjencia, në funksion të ushtrimit të kompetencave të saj, kryen detyrat e mëposhtme:

a) Merr masat për të zhvilluar mekanizmat për gjithëpërfshirjen e qytetarëve në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore, si dhe monitorimin e zbatimit të këtyre mekanizmave;

b) Merr masat që, nëpërmjet mekanizmave të posaçëm institucionalë, të koordinojë institucionet e administratës shtetërore për zhvillimin e praktikave të mira dhe përdorimin e tyre në të gjithë administratën shtetërore për gjithëpërfshirjen e çdo qytetari në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore;

c) Ndjek trajtimin e kërkesave dhe të ankesave të qytetarëve e të subjekteve të paraqitura në seksionet e veçanta të Platformës mbi veprimtarinë e institucioneve shtetërore, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

ç) Kërkon dhe merr nga institucionet e administratës shtetërore çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësive të saj;

d) Merr masa që, në rastet kur çmon se ofrimi i shërbimeve publike nuk mund të realizohet me efektivitet, për shkak të pengesave që krijohen nga rregullat dhe procedurat e brendshme, nga struktura e institucionit të administratës shtetërore ose aktet ligjore ose nënligjore në fuqi, të rekomandojë ndryshimin e rregullave dhe të procedurave të brendshme të institucioneve ose të strukturës së tyre, si dhe t’i propozojë institucionit përgjegjës ndërmarrjen e nismës për ndryshimin e akteve ligjore ose nënligjore;

dh) Bashkëpunon me ministritë e linjës, institucionet e varësisë, shoqërinë civile dhe institucionet ndërkombëtare për mbështetjen dhe promovimin e projekteve, aktiviteteve, nismave, bashkëpunimeve për një shoqëri të institucioneve të hapura dhe të dialogut të gjerë;

e) Bashkëpunon me ministritë e linjës, institucionet e varësisë, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare të shkencës, të arsimit, të artit dhe të kulturës për mbështetjen dhe promovimin e një imazhi të ri për vendin tonë dhe rajonin, si simbole të bashkëjetesës paqësore e udhërrëfyes në ndërtimin e saj;

ë) Zhvillon bashkëpunime dypalëshe dhe shumëpalëshe me sektorin publik e privat, vendas dhe të huaj, në shërbim të realizimit të misionit të institucionit;

f) Kontribuon dhe bashkëpunon në zhvillimin e politikave, të legjislacionit, të strategjive për inovacionin, krijimtarinë, transparencën, arsimin, rininë, shkencën, artin, kulturën, grupet vulnerabël për institucione më pranë qytetarëve dhe shoqërisë civile, si dhe zbaton e kontribuon në strategjitë qeveritare për krijimin e mjeteve për mbështetjen e nismave inovative të dialogut, të bashkëpunimit e të bashkëjetesës në rajonin tonë;

g) Propozon e inicion nisma dhe menaxhon aktivitete në funksion të tyre, në përmbushje të misionit të institucionit, brenda dhe jashtë vendit, mbështetur në legjislacionin shqiptar ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dy- apo shumëpalëshe;

gj) Organizon, mbështet, bashkëpunon dhe/ose mundëson realizimin e projekteve inovative të studentëve, të studiuesve, të artistëve, të kuratorëve, të gazetarëve dhe të aktivistëve të shoqërisë civile për sigurimin e mjeteve e të mundësive për ndikimin e politikave publike dhe krijimin e një dialogu të gjerë, që siguron institucione të hapura, transparente e më pranë qytetarëve;

h) Harton plan vjetor për nisma e aktivitete me interes publik, si dhe për aktivitete kulturore, artistike, letrare, rinore, të tilla si ekspozita, promovime, shfaqje, takime, debate, seminare, konferenca, pritje e të tjera të këtij lloji, në mbështetje të studentëve, të studiuesve, të artistëve, të kuratorëve, të gazetarëve dhe të aktivistëve të shoqërisë civile, si dhe organizon e kujdeset për realizimin e këtyre aktiviteteve;

i) Shqyrton kërkesa të veçanta, të ardhura përmes postës elektronike zyrtare dhe/ose rrugëve zyrtare jashtë planit të hartuar sipas shkronjës “h”, të kësaj pike, të paraqitura prej individëve ose grupeve të tyre, për realizimin e aktiviteteve të tilla, si dhe, nëse i vlerëson të vlefshme, i organizon e kujdeset për realizimin e këtyre aktiviteteve;

j) Merr masat për të realizuar kontrollin e veprimtarisë administrative që kryhet nga institucionet e administratës shtetërore për ofrimin e shërbimeve publike, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin për bashkëqeverisjen, si dhe në vendimin përkatës të

Këshillit të Ministrave, të miratuar në zbatim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

k) Merr masat për të ndërmjetësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet institucionit të administratës shtetërore, qytetarëve apo subjekteve private, sipas përcaktimeve të kreut VIII, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

l) Merr masat e nevojshme për të siguruar inspektimin e zbatimit të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, si dhe për të monitoruar ndjekjen e masave të dhëna në përfundim të inspektimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ll) Administron bazën e të dhënave dhe sistemet e Platformës dhe propozon ndryshime sipas parashikimeve në ligjin për bashkëqeverisjen;

m) Administron bazën e të dhënave të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) dhe propozon ndryshime në varësi të nevojës për përmirësim;

n) Lidh marrëveshje bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e çështjeve që janë përgjegjësi e fushës së veprimtarisë së tyre, sipas përcaktimeve të kreut IX, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, si dhe në funksion të aktiviteteve të përcaktuara në shkronjat “g”, “gj”, “h” dhe “i” të kësaj pike, duke negociuar me këto njësi edhe për stafin, mjetet teknike, mjediset pranë tyre ku do të realizohen aktivitetet apo mjediset e nevojshme për administrimin e tyre, si dhe për zbatimin e metodave të bashkëqeverisjes;

nj) Lidh marrëveshje, sipas ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, dhe merr pjesë në programe të përbashkëta e veprimtari me institucione dhe autoritete të tjera shtetërore, vendase apo të huaja;

o) Ndërton dhe administron faqet zyrtare të internetit, të destinuara për informimin e qytetarëve dhe të shoqërisë civile për veprimtarinë e Agjencisë, mbarëvajtjen e seksioneve të Platformës dhe raportimet periodike të saj, veprimtarinë dhe aktivitetet e COD-it, si dhe çdo aktivitet tjetër të saj;

p) Publikon dhe informon publikun në mënyrë të vazhdueshme për çdo veprimtari për rritjen e rolit të qytetarëve në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e nismave, të projekteve ose të programeve të përbashkëta, që kanë si qëllim përfshirjen e qytetarëve në bashkëqeverisje dhe mënyrën e pjesëmarrjes së qytetarëve në to;

q) Informon për rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen për ndërmarrjen e nismave me interes publik, në përmbushje të qëllimeve të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

r) Zbaton detyrat sipas metodave dhe seksioneve të tjera të bashkëqeverisjes, të cilat miratohen sipas pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”;

rr) Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi apo Kryeministri.

8. Agjencia, gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara në shkronjat “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të pikës 7, të këtij kreu, u ofron të tretëve të përfshirë në aktivitete , si: studentëve, studiuesve, artistëve, kuratorëve, gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile shfrytëzimin pa kundërshpërblim apo tarifë të mjediseve të saj në funksion të këtyre aktiviteteve të përkohshme.

9. Në rastet kur gjatë procedurave të inspektimit, sipas përcaktimeve të ligjit për bashkëqeverisjen, koordinatorët e Agjencisë konstatojnë shkelje që përbëjnë kundërvajtje administrative, në kuptim të dispozitave të këtij ligji, zbatohet procedura, si më poshtë vijon:

a) Koordinatorët plotësojnë procesverbalin e konstatimit të shkeljes, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, si dhe të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

b) Procesverbali përmban një raport të hollësishëm për inspektimin e kryer, gjetjet, si dhe analizën e kualifikimin ligjor të fakteve, sipas rasteve të parashikuara në ligjin për bashkëqeverisjen, duke cilësuar kundërvajtjen konkrete. Në përfundim të raportit

përkruhet masa që propozohet të merret ndaj institucionit, nëpunësit përgjegjës dhe/ose titullari, në mbështetje të ligjit për bashkëqeverisjen.

c) Në rastet kur është i zbatueshëm edhe sanksioni administrativ me gjobë, koordinatori i Agjencisë duhet të përshkruajë në procesverbal edhe analizën për efektshmërinë dhe proporcionalitetin e gjobës që propozohet ndaj institucionit, nëpunësit përgjegjës dhe/ose titullarit, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për bashkëqeverisjen. Në përfundim të kësaj analize, në procesverbal propozohet masa e gjobës brenda vlerave të përcaktuara në ligjin nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”.

ç) Në mbështetje të procesverbalit, koordinatori harton urdhër për vendosjen e masave dhe, nëse është rasti, urdhër për vendosjen e gjobave dhe ia paraqet atë eprorëve dhe drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë për miratim.”.

10. Agjencia ka stemën dhe logon e vet zyrtare, sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi. Stema e Drejtorisë së Përgjithshme përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Drejtoria e Përgjithshme”.

11. Vula e Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, buxheti i parashikuar për vitin 2022, si dhe të gjitha të drejtat, detyrimet, aktivet dhe pasivet e institucionit të krijuar me vendimin nr. 638, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, i kalojnë institucionit “Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje” që organizohet dhe funksionon sipas këtij vendimi.

2. Punonjësit e institucionit të krijuar me vendimin nr. 638, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, konsiderohen punonjës të Agjencisë për një periudhë kalimtare 6-mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, nëse nuk preken nga ristrukturimi, si dhe nëse plotësojnë kriteret dhe zotërojnë njohuritë e nevojshme për pozicionet e punës. Në çdo rast, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë kësaj periudhe, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

3. Vendimi nr. 638, datë 6.11.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

